



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## TE DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

<b>Emri i NSH-së</b>	<b>NSH Mekanizimi, Prishtinë</b> (“Ndërmarrja”)
<b>Emri i Ndërmarrjes së Re</b>	<b>Ndër. e Re Mekanizimi Shitorja Ferizaj SH.P.K.</b> (“Ndërmarrja Subsidiare”)
<b>Vendndodhja</b>	Ferizaj
<b>Biznesi/Spektori</b>	<p>Historikisht, Ndërmarrja ka qenë furnizues i makinave dhe pajisjeve bujqësore me njësi në tërë Kosovën.</p> <p>Aktualisht, të hyrat kryesore të Ndërmarrjes krijohen nga e ardhura nga qiraja e cila merret nga lëshimi me qira i njësisve të Ndërmarrjes palëve të treta.</p>
<b>Prodhimet</b>	N/A
<b>Tregu</b>	Ndër. e Re me lokacionin e saj strategjik ofron mundësinë për të zhvilluar aktivitete komerciale dhe të qiradhënies.
<b>Konkurrenca</b>	Aktualisht tregu është mjaft konkurrues, pasi që në vitet e fundit në Kosovë ka pasur rritje të konsiderueshme të qiradhënies të pronave dhe aktiviteteve komerciale.
<b>Fuqia punëtore</b>	Asnjë punëtor i Ndërmarrjes nuk do të transferohet në Ndërmarrjen e Re.
<b>Ndërtesat dhe tokat</b>	<p><b>Ndërmarrja e Re Mekanizimi Shitorja Ferizaj SH.P.K.</b> përfshinë vetëm lokalit afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 146.16m<sup>2</sup> i cili gjendet në katin përdhës të një ndërtese shumëkatëshe të banimit në Rr. Dëshmorët e Kombit, në qendër të Ferizajt.</p> <p>Dokumenti i vetëm lidhur me pronësinë e lokalit, të cilin e posedon AKP-ja është Vendimi i Komunës së Ferizajt nr. 3094-66 i datës 30.04.1966. Sipas këtij vendimi, NSH Mekanizimit i lejohet themelimi i depon për shitje me shumicë dhe pakicë.</p> <p>Aktualisht lokali afarist shfrytëzohet nga Bekim Aliu pa marrëveshje të qirasë me AKP-në apo NSH-në.</p> <p>Nuk ka tokë që do të transferohet blerësit të ri.</p>
<b>Detyrimet që do të barten:</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>(1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjokat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;</li><li>(2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12</li></ol>

Rr. Rexhep Mala nr.2  
10000 Prishtinë, Kosovë,  
Tel: 038 226 889,  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org),  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

- (3) Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve ( duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
  - a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
  - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-se.

#### Shikim parcial i Ndër. Re



#### Informata

Departamenti për Shitje  
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)  
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255  
Fax: +381 (0) 38 248 076  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

#### Dokumentet për Ofertë

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)  
Rruga Ilir Konushevci Nr. 8  
10000 Prishtinë/Pristina, Kosovo

Rr. Rexhep Mala nr.2  
10000 Prishtinë, Kosovë,  
Tel: 038 226 889,  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org),  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)